



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:101640
Datë: 29.04.2024
Numri i dokumentit: 05634877

CAP.nr.911/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren individuale Hidajete Gashi Alaj, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit H.R nga Gjakova, rruga "...” nr.175, të cilin me autorizim e përfaqëson K.B, avokat në Gjakovë, kundër debitorit N.R nga Gjakova, të cilin me autorizim e përfaqëson G.R nga Gjakova, rruga "...”, numër ..., sipas dokumentit përmbartimor – aktvendimi C.nr.438/18 i datës 29.04.2020, i formës së prerë nga data 12.11.2020, për shkak të borxhit në shumë prej 946.40, duke vendosur në lidhje me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë –Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.173/21, i datës 15.02.2023 me datë 29.04.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e debitorit N.R nga Gjakova, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.173/21, i datës 15.02.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjakovë –Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin PPP.nr.173/21, i datës 15.02.2023 ka vendosur:

“I. REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit N.R, i ushtruar ndaj urdhrit të përmbartuesit privat Gjokë Radi, me seli në Gjakovë, P.nr.340/21 të datës 31.05.2021, mbi lejimin e përmbartimit.

II. DETYROHET debitori që kreditorit t'ia paguaj shpenzimet procedurale në lartësi prej 156.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

III. Ankesa kundër këtij Aktvendimi nuk e ndalon procedurën përmbarimore.”

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori pa i specifikuar bazat për të cilat e kundërshton aktvendimin, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar ndërsa aktvendimi i Gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe çështja t'i kthehet Gjykatës Themelore në rishqyrtim dhe rivendosje .

Përgjigje në ankesë ka parashtruar kreditori me propozim që ankesa e debitorit të refuzohet e pa bazuar ndërsa aktvendimi i Gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Gjyqtarja individuale e Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se :

-Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori me datën 31.05.2021, ka paraqitur propozim pranë Organit përmbarues, në bazë të aktgjykimit të plotfuqishëm, C.nr.438/18, i datës 29.04.2020 dhe aktgjykimit korrigjues dhe plotësues, C.nr.438/18, i datës 28.05.2020.

Përmbaruesi private, me urdhrin, P.nr.340/21, i datës 31.05.2021 ka lejuar përmbarimin e vendimit.

Pas pranimit të urdhrit për përmbarim, debitori në afat ligjor ka paraqitur prapësim pranë Gjykatës së shkallës së parë me propozim që të aprovohet prapësimi si i bazuar ndërsa aktvendimi i Gjykatës të shfuqizohet dhe të prishen të gjitha veprimet e zbatuar sipas aktvendimit të përmendur.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin, PPP.nr.173/21, i datës 15.02.2023 e ka refuzuar prapësimin duke vendosur më decidivisht sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktvendimit ka theksuar se në rastin konkret kreditori ka kërkuar lejin e propozimit për përmbarim për pagesën e shpenzimeve procedurale të procedurës kontestimore, me kamatë përkatëse ligjore, sipas dokumentit përmbarimor – aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me numër C.nr.438/18 i datës 29.04.2020, i formës së prerë nga data 12.11.2020 dhe i ekzekutueshëm nga data 05.06.2020, i përmirësuar me aktvendimin C.nr.438/18 i datës 28.05.2020, i cili aktvendim ka titull përmbarues, duke u bazuar në nenin 22 paragrafin 1, nën par.1.1. të LPP-së dhe ky vendim është i përmbarueshëm në bazë të nenit 24 par 1 të LPP-së,

pasi që i njëjti ka marrë formën e prerë me datë 12.11.2020, si dhe ka skaduar afati për përmbushje vullnetare dhe i njëjti është bërë i ekzekutueshëm që nga data 05.06.2020, si dhe njëkohësisht është edhe i përshtatshëm për përmbarim në kuptim të nenit 27 par.1 të LPP-së, pasi që në aktvendimi sipas së cilit është lejuar urdhri përmbarimor janë të përfshira të gjitha këto elemente, andaj gjykata ka vlerësuar së ky vendim i plotëson të gjitha kushtet e lartcekura ligjore për tu caktuar dhe zbatuar përmbarimi sipas tij.

Tutje Gjykata ka theksuar se i ka vlerësuar pretendimet e debitorit lidhur me ligjshmërinë e dokumentit përmbarimor, por këto pretendime i mori si të pa bazuara, pasi që gjykata, gjithmonë duke u bazuar në parimin e rigozitetit formal të procedurës përmbarimore, e njëjta nuk ka tagër që të lëshohet në ligjshmërinë materiale dhe rregullsinë e dokumentit përmbarues, në bazë të të cilit kërkohet përmbarimi. Gjykata në këtë rast kujdeset vetëm në çështjen e asaj se a është bërë propozimi për përmbarim dhe a është lejuar përmbarimi në bazë të dokumentit përmbarues siç kërkohet me dispozitat ligjore në fuqi.

Gjykata e shkallës së parë aktvendimin përkitazi me refuzimin në rastin konkret e ka mbështetur edhe në nenin 71 të LPP-së pasi që gjeti se pretendimet e paraqitura në prapësim nga ana e debitorit nuk hyjnë në shkaqet e parapara me këtë nen, të cilat po që se ekzistojnë mund të pengojnë përmbarimin e lejuar, si dhe në nenin 69 paragrafi 4 të LPP-së, pasi që debitori nuk ja ka bashkangjitur as edhe një provë të vetme me shkrim prapësimit, e cila do të mund të ndryshonte mënyrën e vendosjes së këtij aktvendimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është nxjerrë konform nenit 13 dhe 17 të LPK-së lidhur me nenin 452 të LPK-së dhe atë për shpenzimet procedurale për përpilim të përgjigjes në prapësim nga avokati në shumë prej 156.00 euro.

Për vendosjes si në pikën III të dispozitivit Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se është bazuar në nenin 77 paragrafi 5 të LPP-së.

Gjykata e Apelit, vendimin e gjykatës së shkallës së parë e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshatirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë vlerëson se urdhri për përmbarim është lëshuar në përputhje me dispozitat ligjore të LPP-së dhe atë për faktin se propozimi për përmbarim është bërë në bazë të dokumentit të përmbarues –vendimi i Gjykatës i përcaktuar me nenin 22 par.1 nën par 1.2 të këtij ligji i cili përcakton se: *“1. Dokumente përmbaruese janë: 1.1. vendimi përmbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbaruese;*, po ashtu Ligji për procedurën përmbarimore e përcakton edhe çka konsiderohet vendim i Gjykatës ku neni 23 par.1 përcakton se: *“1. Sipas këtij ligji, vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit, kurse ujdi gjyqësore*

konsiderohet ujdia e arritur përpara Gjykatës dhe arbitrazhit si dhe marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit”, andaj duke u bazuar në dispozitat ligjore të sipërcituara kjo Gjykatë vlerëson se urdhri për përmbarrim është lëshuar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe i përmban të gjitha elementet e përcaktuara me këto dispozita andaj nuk ekziston asnjë shkak që kjo Gjykatë të mos e përkrah vendimin e gjykatës së shkallës së parë si të drejtë dhe të ligjshëm.

Po ashtu, kjo Gjykatë vlerëson se propozimi për përmbarrim është bërë në përputhje edhe me nenin 36 par.1 të LPP-së i cili përcakton se: *“Së bashku me propozimin për përmbarrim, organit përmbarrues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarrues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarrueshmëris për përmbarrueshmëri.”* Vendimi i Gjykatës në bazë të te cilit është bërë propozimi për përmbarrim është bashkëngjitur në origjinal dhe i njëjti e përmban vulën plotfuqishmërisë dhe të ekzekutueshmërisë, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 28.05.2020, ndërsa i ekzekutueshëm me datë 05.06.2020.

Meqenëse debitori me ankesë nuk ka paraqitur asnjë shkak me të cilin do të vërtetonte se ekzistojnë arsyeje të cilat do të bënin dokumentin të pa përshtatshëm për tu përmbarruar, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur e ka refuzuar prapësimin si të pa bazuar duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, duke e konsideruar vendimin e gjykatës së shkallës së parë të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.911/2023, me datë 29.04.2024

Gjyqtarja
Hidajete Gashi Alaj d.v